



Ndal Punës së Fëmijëve

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve
nëpërmjet edukimit,
artit dhe medias

Intervista dhe sondazhe

Objektivi: Realizmi i një interviste ose sondazhi në grupe të interesuarish



Përfundimi: Nxiti dhe mbështet interesimin në rritje të komunitetit. Paraqet teknikat e intervistimit dhe nxiti studimin dhe verifikimin e gjendjes së çfarë bëjnë për punën e fëmijëve njerëzit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë.

Koha

3-4 orë mësimi

Motivimi

Një ndër çështjet që ngrihet në modul, është që gjithkush në shoqëri duhet të luajë një rol të caktuar dhe të ketë përgjegjësi të caktuara në fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Nuk është e mjaftueshme të mendosh se disa qeveri dhe Kombet e Bashkuara merren me këtë problem. Komuniteti ndërkombëtar po bëhet gjithmonë e më i ndjeshëm ndaj gjithçkaje që ndodh edhe në cepat më të thellë të botës. Në vitet e fundit, përpjekjet e komuniteti ndërkombëtar janë drejtuar ndaj atyre vendeve që po çfiliten nga luftërat civile dhe forcat shkatërruese të natyrës, duke ndihmuar qeveritë dhe popullsinë e tyre.

E megjithatë, në botë ende ka miliona fëmijë që punojnë dhe problemi i tyre nuk zgjidhet nga zgjidhjet paqësore të konflikteve në këto vende. Për këtë problem, mediat nuk flasin çdo ditë. Bëhet fjalë, në shkallë të gjerë, për fëmijë që jetojnë në varfëri ekstreme, të privuar nga e drejta për t'u arsimuar, nga e drejta për të



Shënim për përdoruesin

Ky modul është mirë të zhvillohet menjëherë pas modulit "Studimi dhe informacioni". Përfundimet e tij përbëjnë një themel solid mbi bazën e të cilit jepen teknikat e intervistimit, si dhe për të përforcuar procesin e studimit për të cilin grupi është i informuar.



jetuar fëmijërinë, madje edhe për të patur një familje. Puna e fëmijëve nuk është një problem që mund të zgjidhet me veprime bamirësie. Jo rrallë ndodh që shumë vende, madje dhe persona të veçantë mendojnë se duke dhuruar para, mund të zgjidhet problemi dhe të ndiehen të qetë, duke e zhveshur veten nga çdo lloj përgjegjësie. Jo nuk është kështu. Përgjegjësia është diçka më e madhe se kjo dhe nuk mund ta heqësh qafe lehtësisht.

Atëhere çfarë mund të bëjmë dhe çfarë duhet të arrijmë? A mund të mendojmë se mobilizimi i të rinjve mund të jetë i suksesshëm për të arritur atje ku të tjerët kanë dështuar? Ndoshta po shkarkojmë të gjithë përgjegjësinë tonë në shpatullat e njoma të të rinjve? Jo, nuk është kështu. Në po përpiqemi të punojmë më të rinjtë, të shfrytëzojmë energjinë, aftësinë e tyre krijuese për të krijuar burime edukimi të komunitetit-agjentët e ndryshimit dhe të mobilizimit social. Siç është thënë më shumë se një herë, ky problem i takon komunitetit dhe të rinjtë janë e tashmja dhe e ardhmja e tij.



Por komunitetet nuk përbëhen vetëm nga të rinjtë. Ato përbëhen nga politikanë, punëtorë, prindër, mësues, sindikalistë, industrialist, shitës, sportistë, artistë, nga e gjithë shoqëria.

Çfarë bëjnë këta për të na ndihmuar? Madje, a janë të ndërgjegjësuar për këtë problem? A e dinë se duhet dhe mund të bëjnë diçka për të ndryshuar gjendjen?

Në kuadër të procesit pedagogjik, ky modul ka disa qëllime. Të rinjve natyrshëm do t'u lindë pyetja se për çfarë u duhen të gjitha informacionet e marra nga zhvillimi i moduleve të tjera. Çfarë duhet të bëjnë me këto njohuri të marra? Ata, nëpërmjet realizimit të këtij moduli, do të kenë mundësi të vënë në jetë të gjitha njohuritë e marra, aftësitë e përfituara në drejtim të kërkimit. Duke realizuar intervista me personalitete të njohura në komunitet, ata do të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë e tyre shoqërore dhe komunikuese që janë shumë të rëndësishme në jetën e përditshme. Të rinjtë e grupit do të zbulojnë se çfarë dinë të tjerët për punën e fëmijëve, çfarë përpiqen të bëjnë, madje dhe se kush janë personat në shoqëri që mund të bëjnë diçka

konkrete për këtë problem. Disa prej tyre, si: politikanë dhe drejtues kryesorë të ndërmarrjeve të mëdha, mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Por në të vertetë, a bëjnë ndonjë gjë? Pikërisht, këtë gjë dëshirojmë të zbulojmë të rinjtë.

Në të njëjtën kohë, gjatë zhvillimit të intervistave, duke hyrë në marrëdhënie me komunitetin, të rinjtë do të rivlerësojnë rolin e tyre si edukatorë. Personat që do të intervistohen, do të dëshirojnë të dinë se përse pikërisht ata po intervistohen për punën e fëmijëve. Do të dëshirojnë të mësojnë se çfarë dinë intervistuesit në lidhje me punën e fëmijëve dhe çfarë bëhet apo mund të bëhet për ta mënjeluar plotësisht atë. Disa ndoshta nuk do të ndihen mirë ndaj këtyre intervistave, madje të tjerë nuk do të pranojnë të japin intervista. Kjo e fundit, mund të bëhet një mësim shumë i mirë për të rinjtë që do të pyesin si është e mundur të kundërshtosh një kërkesë të tillë: një pyetje së cilës duhet t'i përgjigjesh me sinqeritet.

Përgatitja

Jemi të ndërgjegjshëm që niveli i realizimit të këtij moduli do të jetë i ndryshëm nga një vend në tjetrin, nga një grup në tjetrin në përputhje me sjelljen, kulturën dhe traditën e vendit. Ju takon juve të vendosni nëse ky modul mund të realizohet ose jo në realitetin tuaj, cilat mund të jenë pasojat dhe nëse vetë procesi pedagogjik do të ketë përfitim apo jo. Kushti i parë është që të rinjtë të ndiehen të qetë dhe të sigurtë. Mos zhvilloni pjesë të caktuara të modulit, nëse mendoni se mund të ndikojnë negativisht tek grupi.



Ndihma e jashtme

Ky modul është i thjeshtë dhe nuk ka nevojë për ndihmë të jashtme. Gjithësesi, çfarëdo ndihme e ofruar në lidhje me procesin dhe mbledhjen e informacionit, duhet të pranohet me mirënjohje. Nëse jeni me fat, bibliotekat e qytetit që ju kanë ndihmuar për modulën e kërkimit dhe të informacionit, mund t'ju ofrojnë përsëri ndihmë dhe mbështetje. Procesi i përgatitjes së intervistave dhe të kërkimit parashikon edhe një punë paraprake të grupit.

Nëse punoni brenda në shkollë, mund t'i kërkoni ndihmë ndonjë mësuesi të matematikës ose ndonjë specialisti të statistikës. Por edhe nëse nuk punoni në shkollë, ju mund të njihni ndonjë mësues që jep lëndët e mësipërme. Mbështetja dhe ndihma e tyre mund të jetë e dobishme në lidhje me interpretimin e të dhënave dhe të statistikave.

Gjithashtu do të jetë e dobishme për ju, përfshirja në realizimin e modulit të ndonjë gazetari në lidhje me teknikat e intervistimit. Identifikoheni dhe kontaktoni me të në mënyrë që t'i shpjegoni natyrën e projektit dhe sondazhin që do të bëni. Nuk keni se çfarë të humbni, por kontaktoni dhe kërkoni ndihmën e gazetarit, pasi do të jetë shumë e dobishme në përgatitjen e intervistës dhe realizimin e saj.



Gjithësesi, mos e kërkoni medoemos këtë mbështetje nga jashtë, por njëkohësisht vlerësojeni edhe këtë mundësi. Module të tilla nuk bëhen për ta mbingarkuar mësuesin apo drejtuesin e grupit. Objektivi i modulit nuk është të përgatisë ekspertë në interpretimin e të dhënave dhe në realizimin e intervistave. Gjithësesi, të rinjtë do të përfitojnë shumë nga njohja e këtyre teknikave dhe përfitimi i aftësive të reja. Mbi bazën e informacionit që ofron moduli, mësuesi duhet të jetë në gjendje ta realizojë vetë veprimtarinë. Gjithësesi, në kuadër të procesit edukativ të komunitetit, është e nevojshme të afrosh dhe pjesëtarë të tjerë, në mënyrë që të shikohet si dhe me çfarë mund të ndihmojnë për realizimin e projektit. Shumë njerëz do të ndiehen të kënaqur të marrin pjesë dhe të japin falas ndihmën e tyre për një kauzë të drejtë.

Çfarë duhet

- ✓ Letër, lapsa dhe stilolapsa.
- ✓ Dërrasë (të zezë o të bardhë) ose tabakë të mëdha letre.
- ✓ Materiale për punën e fëmijve (materiale që ka në modulet "Informacioni kryesor" dhe "Kërkimi dhe informacioni").
- ✓ Nëse është e mundur, përdorimi i internetit.
- ✓ Lista me emra të personave publikë, përfaqësues të politikës, ndërmarrjeve të punës, të organizatave të ndryshme që mund të intervistohen
- ✓ Nëse është e mundur, videokamera.



Zhvillimi i modulit

Organizimi i grupit do të varet nga dinamika dhe numri i pjesëtarëve, si dhe aftësitë e impenjimi i tij. Në këtë modul do të ballafaqohemi me kërkimin e informacionit, interpretimin e tij, realizimin dhe drejtimin e intervistave. Realizimi i intervistave si në planin e përgatitjes, ashtu edhe gjatë zhvillimit del se është me efektiv kur bëhet në grupe të vogla 2-3 veta, edhe pse kjo varet shumë edhe nga personi që intervistohet. Sondazhet mund të përgatiten nga i gjithë grupi. Nëse vendosni të bëni më shumë se një, atëherë ndajeni grupin në nëngrupe.

Në momentin e përgatitjes së intervistës, të rinjtë punojnë më mirë në grupe se vetëm. Edhe në këtë rast ka të bëjë shumë kurajoja dhe besimi që kanë të rinjtë në veteve. Do të ishte një kërkesë e tepruar t'i kërkoje vetëm një të riu të përgatiste edhe sondazhin, edhe intervistën. Përvoja ka treguar se gjatë një interviste arrihen rezultate shumë të mira nëse angazhohen 2-3 veta. Nëse personat që do të intervistoni, janë më shumë se një, atëherë mund të përfshini më shumë të rinj. Bëni kujdes që të arrini qëllimin tuaj: aktivizimin e secilit të ri në procesin e sondazhit dhe të intervistës.

Organizimi i grupit



Në organizimin e nëngrupeve bëni kujdes që secili prej tyre të punojë me temp. Të rinjtë duhet të punojnë me dëshirë në skuadër, veçanërisht në periudhën e kërkimit, në të cilën duhet të përfshihen të gjithë.

Veprimtaria 1: Sondazhi

2 – 3 orë mësimi, si dhe koha që duhet për të realizuar sondazhin.



Shënim për përdoruesin

Realizimi i sondazhit është me dëshirë. Në modul shpjegohet mënyra e realizimit, por nuk është e detyrueshme që ta bëni. Me dëshirë mund të vendosni që të realizoni sondazhin e intervistën, vetëm intervistën ose asnjërën. Por, nëse është e mundshme, ju këshillojmë

Ç'njohuri ka grupi për punën e fëmijëve, sa shqetësohen anëtarët e tij? A janë ata të ndërgjegjshëm se secili prej tyre mund të luajë një rol në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijës? Sa të interesuar janë të rinjtë e grupit për të mësuar se ç'dinë të tjerët për këtë problem? A janë ata të kënaqur që po bëjnë këtë sondazh, si do ta bëjnë atë të njohur tek të tjerët? Sondazhet janë të dobishme, sidomos, gjatë procesit të ndërgjegjësimit. Grupi juaj do të ketë grumbulluar një sasi të mjaftueshme informacioni për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me punën e fëmijëve. Për ta është një përvojë shumë e dobishme që këtë informacion ta vënë në përdorim, si dhe të informojnë të tjerët, tërthorazi, se çfarë po bëjnë për punën e fëmijëve.

Thirreni grupin në sallën e takimit apo në klasë dhe ftojini anëtarët të ulen siç ulen nxënësit në klasë apo rreth jush (në formë patkoi). Në këtë stad, ata nuk kanë nevojë për ndonjë material. Bëni të njohur qëllimin e mbledhjes në bazë të paragrafëve të mësipërm dhe shpjegoni se çfarë kuptojmë me sondazh: pse kryhen sondazhet në shoqëri; cilët organizma kryejnë sondazhet, si, p.sh., kompanitë e marketingut, qeveritë, OJQ-të dhe sindikatat; si i përdorin ato rezultatet. Shpjegoni sa të rëndësishëm janë sondazhet për të vlerësuar prirjet dhe sjelljet dhe pse sondazhet janë thelbësore në fushatën për të zhdukur punën e fëmijëve.

Natyra e sondazhit

Së pari, duhet t'u japim përgjigje disa pyetjeve bazë, si: nëse dëshirojmë të bëjmë sondazhin dhe si ta drejtojmë atë. Takimi duhet të marrë formën e një debati. Në fund të takimit, anëtarët e grupit duhet të kenë fituar një ndjenjë

pronësie për sondazhin dhe të jenë të gatshëm për të filluar përgatitjet. Një anëtar i grupit duhet të caktohet si raportues dhe të drejtojë diskutimet sipas një skeme të paraqitur në dërrasë të zezë, në tabakët e letrës ose të mbajë shënime. Çështjet që mund të diskutohen me grupin, janë:

- Përse dëshirojmë të kryejnë sondazhin? Cilat janë qëllimet dhe objektivat, bie fjala, të kërkojnë më shumë informacion, mënyra vlerësimi, të studiojnë sjelljen, procesin e biznesit, t'u kushtohemi përparësive etj.
- Kujt i drejtohen në sondazh? A dëshirojnë të përqendrohen tek një apo disa grupe shoqërore? A kërkojnë të bëjnë një apo disa sondazhe? Kjo do të varet kryesisht nga objektivat dhe qëllimet tona.
- Ç'formë do të ketë sondazhi? A do të ketë ai formën e një pyetësori që të plotësohet dhe më pas të dorëzohet? A do të ketë ai formën e një interviste, d.m.th., një individ interviston një tjetër? A do të jetë një pyetësor që do të dërgohet me postë (për këtë duhet të kemi kujdes se posta ka shpenzime dhe kërkon një kohë të gjatë)?
- Kur dëshirojmë ta bëjmë sondazhin? A ka ndonjë kohë të veçantë që do të ishte më e përshtatshme? Nëse do ta bëjmë në ndonjë shkollë, p.sh., a do të bëhet gjatë kohës së mësimi apo gjatë pushimeve ndërmjet orëve?
- Sa i gjatë dhe i hollësishëm do të jetë sondazhi? Kjo gjë varet nga audienca të cilës i drejtohem, si dhe nga forma që do të ketë. Sidoqoftë, bëjani të ditur grupit se sondazhet duhet të jenë të shkurtra, pasi njerëzit janë të lodhur nga pyetësorë të gjatë dhe të hollësishëm. Nëse bëni intervista një për një, në këtë rast mund të zgjeroni pyetjet kur e shikoni që subjekti është i përgatitur të përgjigjet.
- Cili është kuadri i sondazhit: kur duhet ta hartojmë, ta zbatojmë, ta analizojmë dhe të botojmë përfundimet e tij.



Gjatë diskutimit do të dalin probleme të tjera. Për këtë ju duhet të mbani shënime. Ju duhet të përgatiteni mirë për takimin, në mënyrë që të jepni përgjigje në çdo situatë. Një metodë e mirë për të ngjallur interes dhe pjesëmarrje, është që të bëni të njohur se sondazhi i parë do të përqendrohet te kolegët e anëtarëve të grupit. Ky sondazh do të jetë një sfidë interesante për grupin dhe do t'i zbavisë ata kur ta bëjnë për shokët dhe moshatarë të tjerë.

Një arsye tjetër, që mbështet idenë për të filluar nga moshatarët, është se projekti u kushtohet të rinjve dhe si t'i përfshijmë ata në fushatën për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Sondazhet tek të rinjtë e tjerë do të rritin kuriozitetin për të ditur se me çfarë merren shokët dhe moshatarët e tyre, do të ndikojnë të rritet mundësia e ndërjegjësimit. Kjo është e vërtetë, sidomos, po të punoni në një mjedis shkolle ku nxënës të tjerë mund të kenë dëgjuar rreth këtij projekti. Përveç kësaj, mjedisi i shkollës të jepë mundësi të organizosh një grup të përkryer për sondazh.

Kur diskutimi fillon të bjerë, mbylleni atë. Bëni një përmbledhje të pikave kryesore që u ngritën gjatë diskutimit me raportuesin. Shkuajini ato ose kërkoni të njëjtit pjesëtar t'i shkruajë ato në dërrasë të zezë apo në një tabak të madh për t'i parë të gjithë. Arsyetoni për secilën pikë dhe pyeteni grupin nëse ka ndonjë çështje tjetër; nëse i miraton apo jo ato që janë shkruar. Kur sesioni të ketë përfunduar, ju mund ta ndani grupin në nëngrupe më të vogla ose ta mbani atë ashtu siç është dhe të filloni të përgatisni dhe të zhvilloni sondazhin.



Projektimi i sondazhit

Pasi keni diskutuar secilën nga pikat kryesore të mësipërme dhe keni shkruar përfundimet e diskutimit, grupi ka të gjithë informacionin dhe mjetet që i nevojiten për të hartuar sondazhin dhe pyetjet. Nëse keni gjetur përkrahje për ushtrimin e sondazhit, kjo do të ishte koha më e përshtatshme për të paraqitur njeriun që do t'ju mbështesë në fazën tjetër, e cila është më e vështira për grupin tuaj.

Duke ndjekur me përpikmëri kohën e veprimeve për të cilën keni rënë dakord në grup, në këtë stad ju duhet të hartoni sondazhin dhe pyetjet. Kjo gjë mund të bëhet nga i gjithë grupi, të cilin e drejtoni ju ose individi i jashtëm që ju ka ofruar ndihmë apo në grupe më të vogla, të cilat i kontrolloni dhe i ndihmoni ju dhe individi ndihmës. Specifikimi ndihmon që sondazhi të mos jetë i gjatë dhe lehtëson detyrën e grupit apo të nëngrupeve, i nxit të rinjtë të mendojnë me kujdes se kujt do t'ia bëjnë pyetjet dhe se çfarë kërkon të mësojë grupi.

Kur procesi i hartimit ka përfunduar, grupi mblidhet përsëri për të diskutuar detyrat dytësore. Kjo gjë bëhet për të t'i dhënë dorën e fundit pyetësorit dhe për të kaluar në fazën e dytë, në zbatimin e sondazhit. Gjatë këtij takimi duhet të bëni kujdes që grupi apo çdo nëngrup të ketë punuar mirë për të hartuar projektin. Drejtimi i këtij takimi varet nga ndarja e grupit dhe nga detyrat e dhëna. P.sh.: a u hartuan pyetësorët për grupe të ndryshme individësh që do të intervistohen apo çdo grup kishte të njëjtën detyrë? Meqë pyetësorët supozohet të jenë të qartë, ky proces nuk duhet të jetë shumë i gjatë sa të shkaktojë mërzitje te grupi për të mos kaluar në fazën tjetër.

Pasi pyetësori i sondazhit të ketë përfunduar, në varësi të mundësive që kemi për shkruar dhe për të fotokopjuar, caktoni një anëtar të grupit ta shtypë dhe bëni aq kopje sa nevojiten. Nëse nuk keni as kompjuter as fotokopjues, caktoni dikë që shkruan bukur të rishkruajë pyetësorin me dorë dhe në këtë rast është më mirë që sondazhin ta bëni me gojë dhe një për një. Një anëtar i prej secilit nga nëngrupet e vogla të punës caktohet për të kopjuar pyetësorin e sondazhit. Kur kjo gjë të përfundojë, grupi është i gatshëm për të filluar etapën tjetër.



Shënim për përdoruesin

Për të ndihmuar grupin në hartimin e pyetësorit, ju mund t'i jepni një shembull pyetësori, të cilin mund ta ketë si model. Sidoqoftë, duhet të dini se kjo formë mund të pengojë krijimtarinë dhe imagjinatën e grupit në hartimin e pyetësorit.



Shënim për përdoruesin

Në krye të pyetësorit duhet të jepen instruksione të qarta. Ato duhet të jenë për intervistuesin, nëse sondazhi do të bëhet një për një me bazë verbale ose për atë që përgjigjet, në bazë të një pyetësori të shkruar. Ata që do të japin përgjigjet, duhet të kuptojnë shumë mirë si duhet të përgjigjen. Pyetjet nuk duhet të jenë me dy kuptime ose të paqarta.

Drejtimi i sondazhit



Shënim për përdoruesin

Natyra e sondazhit luan rol në formën e tij. Kjo është e vërtetë veçanërisht në intervistat një për një. Nëse intervistuesi nuk është i pajisur me kamera, magnetofon apo nuk ka shkathtësi, do ta ketë shumë të vështirë për të regjistruar përgjigjet e të intervistuarve. Prandaj, një detyrë e rëndësishme është që në hartimin e programit të sondazhit, të parashikohet një fletë interviste me shumë zgjedhje, d.m.th., të ketë sa më shumë pyetje që të intervistuarit të kenë mundësi të përzgjedhin. Përgjigjet e këtyre pyetjeve duhet të parashikohen që të jenë me po, jo ose nuk e di. Nëse i intervistuari do të ketë vetëm për të vënë ndonjë shenjë në kuti ose të japë përgjigje të shkurtra në fletën e intervistës, kjo detyrë do të jetë shumë më e lehtë. Po kështu do të jetë edhe procesi i mëtejshëm i analizës. Sidoqoftë, në një sondazh për punën e fëmijëve do të ishte me interes të shënonim çdo përgjigje apo ndjenjë që mund të shprehin të intervistuarit.

Sondazhi duhet të përgatitet, të bashkërendohet dhe të planifikohet mirë. Grupi duhet të vendosë kur dhe si duhet të kryhet sondazhi. Nëse dikush duhet të vihet në dijeni, si, p.sh., drejtori apo mësuesit kur sondazhi do të kryhet në mjedis shkolle, kjo gjë duhet të bëhet në kohën e duhur. Mblidheni grupin dhe zhvillojeni sondazhin hap pas hapi, duke shkruar rezultatet e këtij diskutimi. Diskutimi duhet të mbështetet në përgjigje për 5 pyetjet: kush?, çfarë?, kur?, ku? dhe pse?

- Kush është ai tek i cili do të bëjmë sondazhin dhe kush do ta drejtojë sondazhin, d.m.th., kush do të bëjë intervistat dhe kush do të shpërndajë dhe do të mbledhë pyetësorët?
- Ç'formë do të ketë sondazhi, d.m.th., intervista apo pyetje të shkruara?
- Kur do të bëhet sondazhi?
- Ku do të bëhet sondazhi?
- Kur do të jenë gati rezultatet?
- Pse bëhet sondazhi?

Nëse sondazhi bazohet në një pyetësor të shkruar, grupi duhet të vendosë se kur do të ndahen pyetësorët dhe si do të mblidhen përsëri. Duhet të kemi parasysh se për të mos i harxhuar shumë kohë korrespondentit, individi që do ta plotësojë pyetësorin, nuk duhet të jetë i pranishëm. Kështu, nëse ju punoni në një mjedis shkolle, grupi, të cilit ju i drejtoheni, mund të jetë në një klasë të veçantë apo të ndarë sipas klasave që ndjekin, d.m.th., viti i parë apo ai që ju keni caktuar. Pasi të keni biseduar me drejtorin dhe mësuesit e shkollës, pyetësori në shkollë mund të shpërndahet në mëngjes kur fillon mësimi dhe të mblidhet kur ai mbaron. Në ato shkolla që janë me drekë, në pushimin e drekës. Kjo gjë mund të bëhet me ndihmën e trupit mësimor.

- Në shtesën 1 jepen udhëzime për të kryer sondazhin një për një.

Kur është kryer sondazhi dhe grupi ka nxjerrë përfundimet, ju duhet të mblidhni grupin për të diskutuar për fazën tjetër, për analizën.

Në varësi të sasisë së sondazheve dhe të grupeve që u jeni drejtuar, ju duhet të vendosni që analiza të kryhet nga të njëjtët individë që e kryen atë. Është e rëndësishme që ata të kenë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të krenarisë për punën e tyre dhe të respektojnë besimin që ju po u jepni atyre dhe aftësive të tyre. Kjo duhet pasur parasysh se, kur do të botohen rezultatet e këtij sondazhi, përbri emrave të tyre do të shënohet edhe ekipi kërkimor që përgatiti këtë punim. Kjo do t'u japë një ndjenjë vetëvlerësimi, besim, si dhe do të nxjerrë në pah punën e tyre për këtë projekt.

Nëse keni ndonjë njeri që kërkon t'ju ndihmojë për sondazhin dhe nëse ky njeri është statisticien, ky është momenti më i përshtatshëm që t'i kërkonit atij të ndihmojë për të shkruar rezultatet. Ju duhet t'i rregulloni të gjitha nëngrupet në të njëjtën dhomë që ju punoni. Do të ishte më mirë nëse do të kishte mundësi që kjo punë të bëhej në tavolina të ndryshme. Ata duhet të kenë rezultatet e përgjigjeve të sondazhit përball tyre. Ju duhet t'u thoni anëtarëve të ekipit se në fazën tjetër ata do të përmbledhin informacionin e mbledhur.

- **Formati grafik:** nëse pyetjet e sondazhit ofrojnë shumë zgjedhje, atëherë fletët ndahen sipas përgjigjeve, d.m.th., në një vend vendosen, njëra mbi tjetrën, përgjigjet me po, po kështu përgjigjet me jo dhe në një vend tjetër përgjigjet me nuk e di. Nëse keni mundësi të përdorni ndonjë kompjuter, rezultatet shkruhen në fletë të ndryshme, duke i dhënë atij një pamje më profesionale. Kjo gjë mund të bëhet edhe me grafikë apo me letër me kuadrate, duke përdorur edhe ngjyrat. Informoni grupin se secili duhet të shpjegojë për lexuesin hollësitë e paraqitura në grafik apo në tabela, duke mos harruar që të vendosen edhe titujt dhe e gjithë pyetja.

Analiza e sondazhit



Shënim për përdoruesin

Sondazhet janë procese të ndëlikuara, ndërsa kërkimi cilësor është një operacion profesional. Për të rinjtë analizat statistike mund të jenë një punë po aq e vështirë. Sidoqoftë, mos kërkonit shumë nga ky ushtrim dhe bëni kujdes që grupi të jetë shumë konservator në drejtim të grupeve që u drejtohet sondazhi dhe planit të sondazhit. Për këtë arsye, pyetjet tërësore të sondazhit nuk duhet të jenë më të gjata se një deri në dy faqe. Nëse ato janë relativisht të drejtpërdrejta dhe përgjigjet kanë disa zgjedhje, analiza përfundimtare nuk duhet të jetë shumë e vështirë.

- **Formati i shkruar:** Shumë prej pyetjeve, veçanërisht, për këtë çështje të ndjeshme siç është puna e fëmijëve, kanë të bëjnë me pikëpamje dhe opinione të individëve që janë pyetur. Këto duhet të përmbliken në raportet individuale. Shpresojmë se grupi do të ketë ndonjë ide të mirë si ta përmbledhë informacionin. Por, nëse do të ketë nevojë, ai mund të kërkojë ndihmën tuaj apo të ndonjë personi të jashtëm. Shpjegojani ekipit se këtu nuk është puna të prodhohet se çfarë kanë thënë njerëzit, por të nënvizohen dhe të nxirren në pah pikat e përbashkëta të më shumë se një individ. Thojini grupit të përdorë thonjëzat, nëse disa nga përgjigjet kanë qenë mjaft të rëndësishme.

Raporti, në fillim, duhet të shoqërohet me një informacion bazë për sondazhin, me përgjigjet për pesë pyetjet, të cilat i kemi përmendur më parë. Ato duhet të kenë kujdes që çdo paragraf të lidhet mirë dhe të krijojë një rrjedhë natyrore dhe progresive të informacionit. Anëtarët e grupit duhet të shkruajnë edhe pjesën përfundimtare, në të cilën do të nënvizojnë pikat kryesore e do të përshkruajnë se ç'ka arritur sondazhi, sipas tyre.

Bëjuni të ditur nëngrupeve se nuk duhet të frikësohen nga detyra, ato duhet të shkruajnë sa më mirë që të mundin përmbledhjet. Lëvizni ndërmjet nëngrupeve, kur diskutojnë, vizatojnë grafikët dhe tabelat apo shkruajnë raportet. Sigurohuni që çdo njëri syresh është i përfshirë në punë. Ndhimojini të formulojnë se ç'duan të thonë. Ndhimojini të përfundojnë statistikën dhe të vizatojnë grafikët. Kur lëvizni ndërmjet të rinjve, nëse vini re se ndonjë syresh ka shprehur për të vizatuar grafikë dhe tabela ose është i zoti për të përmbledhur informacionin dhe për t'u shprehur mirë në të shkruar, kërkojini nëse dëshiron, të ndihmojë nëngrupet e tjera që mund të kenë vështirësi për të përfunduar raportet e veta.

Po e përsërisim edhe një herë, nëse keni mundësi të punoni me kompjuter, nëngrupet mund t'i shkruajnë raportet e tyre apo t'i përgatisin grafikët me të. Nëse ju nuk keni njohuri për të ndihmuar në këtë fazë, atëherë përpuni të gjeni një tjetër person që mund të ndihmojë nëngrupet për të punuar me kompjuter. Ekipi mund të mësojë mjaft për të përgatitur paraqitjen, gjë që do të zgjerojë njohuritë edukative dhe do të nxitë zhvillimin vetjak të pjesëtarëve të grupit apo të nëngrupeve. Nëse



nuk keni mundësi të përdorni kompjuterin, bëni kujdes që raportet, grafikët apo tabelat të shkruhen mirë me dorë. Tabelat dhe grafikët mund të priten dhe të kopjohen në faqet e shkrimit.

Pasi të përfundojnë raportet, bëni kujdes që anëtarët e secilit nëngrup të shkruajnë emrat e vet në fund të kreut përmbyllës.

Me përgatitjen e raportit, përfundimet e tij ndajini me ata që kanë marrë pjesë në sondazh. Në varësi të vendit ku zhvillohet projekti, këto përfundime mund të publikohen. Lidhuni me redaksinë e gazetës së shkollës, të gazetës lokale apo dhe redaksinë e një gazete kombëtare. Këto përfundime kanë vlerë dhe për persona të tjerë që do të kishin dëshirë t'i njihnin. Pikërisht ky fakt i mbush me besim dhe krenari anëtarët e grupit.

Vazhdimi

Bisedoni me mediat lokale apo dhe kombëtare t'ju japin mundësinë të botoni një artikull që do të mbështetet në përfundimet e raportit (për të patur idenë si duhet të veproni, konsultohuni me modulën "Mjetet e komunikimit, shtypi"). Një ndër qëllimet e projektit është të ndihmojmë të rinjtë të edukojnë të tjerët që të shndërrohen në forcë lëvizëse që do të realizojnë ndryshimin shoqëror.

Ju tërheqim vëmendjen që të ruani të gjitha përfundimet e sondazhit dhe raportin, pasi do të jenë të dobishme në realizimin e moduleve të tjera, si: të mjeteve të komunikimit, shkrimit krijues. Raporti i sondazhit është i rëndësishëm veçanërisht në pjesën e dytë të modulit, të intervista individuale, ku secili pjesëtar i grupit do të takohet me një përfaqësues të komunitetit për ta bindur të përfshihet në diskutimin e përgjithshëm për punën e fëmijëve. Të rinjtë, të pajisur me të dhënat dhe statistikën e nxjerra nga sondazhi, do të dinë t'u imponohen me seriozitet dhe aftësi atyre që do të intervistojnë.

Veprimtaria 2

Intervistat individuale

2 - 3 orë mësimi



Disa nga teknikat e diskutuara dhe të zbatuara më parë mund të përdoren edhe në këtë veprimtari. Intervista do t'i drejtohet një ose më shumë personave të të njëjtit komunitet, p.sh., politikanëve, tregtarëve etj., që të zbulojnë se çfarë bëjnë apo mund të bëjnë anëtarët e një komunitetit për punën e fëmijëve dhe deri në çfarë pike e njohin problemin. Kjo veprimtari mund të zhvillohet në një kuadër më të gjerë, duke iu drejtuar kryetarëve të këtyre komuniteteve. Në të gjitha rastet, pyetjet e sondazhit do të jenë të njëjta. Mënyra si do ta zhvilloni sondazhin, varet nga ju, nga grupi, nga burimet që keni në dispozicion, si dhe nga mundësitë për të vendosur lidhje me përfaqësues të komunitetit përkatës. Nëse dëshironi t'i intervistoni drejtpërdrejt këtë persona, duhet të veproni si më poshtë.

Para se të zgjidhni personat që do të intervistoni, mbliidheni grupin në klasë dhe diskutoni qëllimin dhe objektivat e intervistës. Objektivat janë tre:

- Të informoni komunitetin për zhvillimin e projektit dhe për problemin e punës së fëmijëve;
- Të zhvilloni procesin kërkimor për të nxjerrë në pah shkallën e ndërgjegjësimit të komunitetit për punën e fëmijëve, si dhe çfarë bëhet konkretisht për të ndihmuar fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve;
- Të siguroni mbështetjen e personazheve të njohura të komunitetit, në kuadër të projektit dhe fushatës botërore.

Diskutoni objektivat me grupin, pasi është shumë e rëndësishme që të jenë të qartë për të gjithë. Nxitini të diskutojnë rreth tyre, pasi vetëm kështu pjesëtarët e tij do të jenë në gjendje t'i kuptojnë më mirë dhe të bëhen realizues të tyre.

Shënim për përdoruesin

Nëse nuk e keni zhvilluar pjesën e sondazhit, duhet të diskutoni me grupin ushtrimin e intervistës. Për ta patur më të lehtë, përdorni teknikën e intervistës ballë për ballë, që përshkruhet në shtesën 1.



Para se të zhvilloni intervistën, ju duhet të diskutoni me grupin për përzgjedhjen e personit apo të personave që do të intervistoni. Për këtë, zhvilloni një seancë brainstormingu, që të lokalizoni një grup të ngushtë personash të komunitetit që do të ishte e dobishme të intervistoni. Përzgjedhja do të bëhet mbi bazën e ndihmesës që mund të japin këta persona për zhvillimin e projektit. Gjithësesi, dy ose tri intervista janë të majftueshme dhe mund të zhvillohen me një farë kohe nga njëra-tjetra,

Përzgjedhja e kandidatëve





Shënim për përdoruesin

Përvoja ka treguar që është e dobishme të ftohen personazhe të njohura të komunitetit të takohen dhe të bisedojnë me grupin për natyrën e projektit. Ato mund të ftohen të dëgjojnë krijmtarinë e shkruar, e zhvilluar gjatë projektit, të ndjekin dramën që keni vënë në skenë apo të ndjekin ekspozitat me punime të fëmijëve me temë punën e bashkëmoshatarëve të tyre. Për vetë natyrën që ka projekti, është e pamundshme që këto personazhe të mos i përgjigjen një ftese të tillë. Pikërisht, në kuadër të kësaj vizite mund të zhvillohet edhe intervista me këto personazhe.

P.sh., nëse një politikan merr pjesë në debatin që zhvillohet nga të rinjtë, do të ishte e udhës që menjëherë me përfundim të debatit, të intervistohet për të dëgjuar mendimet dhe komentet e tij për debatin dhe projektin. Intervista do të ketë edhe pyetje për veprimtarinë e politikanëve në lidhje me punën e fëmijëve, si dhe ç'ndihmë duhet të japin për të ndihmuar fushatën botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Ky i ftuar mund të ketë dëshirë të bëhet zëdhënës dhe të promovojë veprimtarinë e projektit dhe të grupit në komunitet. E gjithë kjo veprimtari ka një vlerë të madhe ndërgjegjësuese për komunitetin dhe, njëkohësisht, është një përgjegjësi më e madhe që marrin të rinjtë e grupit mbi vete.

Grupet e mundshme ku do të kërkoni ata që do të intervistoni, janë pesë. Secili prej tyre, për arsye të ndryshme, është me interes për t'u intervistuar.

- **Autoritetet.** Ndërmjet tyre janë përfaqësuesit e qeverisë vendore dhe qendrore, politikanë, aktivistë të partive politike, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar etj.
- **Punëdhënësit.** Të gjitha ndërmarrjet luajnë një rol të rëndësishëm në punën e fëmijëve. Për këtë, është shumë interesante të ballafaqosh më të gjithë punëdhënësit informacionin për kushtet në të cilat prodhohen shumë prej materialeve që ata tregtojnë.
- **Organizata të ndryshme.** Ndërmjet tyre janë sindikatat dhe OJF-të e ndryshme. Disa prej tyre mund të zhvillojnë një veprimtari shumë aktive në fushën e punës së fëmijëve, ndërsa sindikatat janë shumë të rëndësishme për trajtimin e këtij problemi.

- **Personazhe të njohura.** Përsa i përket përfshirjes së këtyre personazheve, ka dy mendime. Mendimi i parë është që pjesëmarrja e personazheve të njohura zbeh rëndësinë e projektit, pasi ata janë shumë të pasur dhe jetojnë në botën e tyre. Mendimi i dytë mbështet pjesëmarrjen e tyre duke e përligjur që çdolloj mbështetjeje që japin, duhet të mirëpritet. Një ndër përparësitë e pjesëmarrjes së tyre është që në këto veprimtari merr pjesë media, duke rritur mundësinë që të pasqyrojë projektin, si dhe që tema e tij t'i bëhet e ditur publikut. Gjithësesi, ju së bashku me grupin do të zgjidhni si do të veproni.
- **Persona të interesuar.** Ndërmjet tyre janë studiues që kanë interes vetjak për punën e fëmijëve, shkrimtarë, artistë, prindër, persona të zakonshëm, të rinj të tjerë etj.

Nëse do të qe e mundshme, do të ishte shumë interesante të intervistohet një përfaqësues nga të gjitha grupet. Intervistat mund të zhvillohen me një person të një grupi ose dhe me disa persona të tjerë që e shoqërojnë. Por edhe kjo zgjedhje varet nga ju, nga kushtet konkrete të vendit tuaj, nga zhdërvjelltësia e grupit etj. Kini kujdes të parashikoni edhe personazhe rezervë për t'u intervistuar, në rastet kur i ftuari juaj nuk ju jep intervistën.



Shënim për përdoruesin

Për këtë veprimtari mundohuni të siguroni një videokamera. Filmimi i intervistave është interesant dhe me vlera edukative. Rishikimi i intervistave është jo vetëm argëtues, por do t'ju ndihmojë të përmirësoni teknikat e intervistimit. Nga ana tjetër, filmimet do të mbeten dhe të rinjtë që nuk kanë marrë pjesë në intervistë, do të kenë mundësi t'i shikojnë. Filmimet duhet të ruhen, sepse paraqesin arritje të projektit.



Pasi të keni përfunduar brainstormingun dhe të keni krijuar një listë me kandidatë të mundshëm për t'u intervistuar, duhet të vendosni së bashku me grupin si do ta zhvillonit intervistën. Do të jetë një intervistë e veçantë apo do të bëhet në kuadër të një veprimtarie tjetër që do të zhvillojë grupi, p.sh., të një debati. Pa dyshim që është një zgjedhje me rëndësi, pasi në shërbim të saj do të ndryshojë përmbajtja e letrës që do t'i drejtohet personit që do të intervistohet.

Lidhjet me kandidatët

Së bashku me grupin duhet të shkruani një leter paraqitjeje për të gjithë personat që mund të intervistoni, për t'i informuar ata rreth projektit dhe ç'kërkoni prej tyre. Bashkëngjitur modulit, në shtesat, keni modele të letrave, të cilat mund t'ju ndihmojnë. Është e natyrshme që përmbajtja e letrës do të ndryshojë në varësi të personit që do t'i dërgohet, si dhe në varësi të natyrës së ftesës. Si, p.sh., grupi do të realizojë vetëm një intervistë dhe kjo do të bëhet në kuadër të një veprimtarie më të zgjeruar.



Shënim për përdoruesin

Në epokën e informatikës, shkrimi i një letrë është një art më vete. Ndikimi i një letrë mund të jetë shumë më i madh se shpërndarja e një qarkoreje, e shtypur në qindra kopje. Për të rinjtë është shumë e dobishme jo vetëm për të tashmen, por dhe për të ardhmen të mësojnë të shkruajnë mirë një letër, të shprehin qartë dhe të prekin lexuesin.

Rregullat kryesore për të hartuar këtë tip letrë, janë si më poshtë:

- të jetë sa më e shkurtër;
- të jetë shkruar me mirësjellje;
- të ketë saktësi në paraqitjen e problemit kryesor;
- të kërkojë një përgjigje;
- të ketë emrin e personit dhe adresën përkatëse kujt i drejtohet.

Për të paraqitur pikat më të rëndësishme të projektit, përdorni metodën e 5 pyetjeve të paraqitura më sipër.

Letra mund të shkruhet nga i gjithë grupi, por në rastet kur do të bëhen më shumë intervista, letrat mund të shkruhen nga nëngrupet. Shkruani në dërrasën e zezë thelbin e secilës letrë, në mënyrë që të gjithë anëtarët e nëngrupeve të orientohen për të përfunduar ushtrimin. Lëvizni nëpër nëngrupet dhe ndihmohuni. Nëse një nëngrup shkruan një letër veçanërisht të bukur, përdoreni si model për grupet e tjera. Letra mund të shtypet në kompjuter. Nëse doni që të ruajë një karakter vetjak, mund të caktoni një anëtar të grupit që ka shkrim të bukur, ta rishkruajë

në të pastër. Çdo letër duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit dhe nga edukatori.

Letra duhet të ndiqet nga një telefonatë, veçanërisht kur u drejtohet politikanëve, biznesmenëve apo njerëzve të shquar të komunitetit. Qetësojeni grupin duke i thënë që nuk duhet të ndryhen kur u drejtohen personaliteteve. Kauza e tyre është e drejtë dhe s'ka asgjë të keqe kur u telefonojnë dhe u flasin me mirësjellje, pas një letre, gjithashtu, të shkruar në po atë stil. Në varësi të shpejtësisë së shërbimit postar, duhet të llogarisni që t'i telefononi pas një jave. Nëpërmjet kësaj telefonate, të rinjtë nxisin personin që t'u kthejë një përgjigje.

Nëse nuk keni mundësi t'u telefononi, mund t'u shkruani një letër të shkurtër ku i kujtoni që jeni në pritje të një përgjigjeje. Ndoshta disa prej personave nuk do të përgjigjen. Në këtë rast mos humbni kohë me ta. Përqendrohuni tek ata që janë treguar më të hapur dhe të gatshëm. Sa më shumë të bëhet i njohur projekti për komunitetin, ndoshta do të ketë përfaqësues të komunitetit që do t'ju telefonojnë apo do të kërkojnë takim me ju për të mësuar më shumë rreth projektit. Kjo, pa dyshim, është një shenjë e mirë ndërgjegjësimit dhe edukimi nga komuniteti.

Pasi të keni shkruar letrën, mblidhni të rinjtë për t'u përqendruar në intervistën për të qartësuar ç'pyetje do të bëjnë. Nëse ka raste që të intervistuarit duan të dinë më parë natyrën e pyetjeve që do t'u bëhen, u jepni ato, pasi qëllimi juaj nuk është t'i kapni në befasi. Duke i ditur pyetjet më parë, ata do të përgatiten më mirë për të dhënë përgjigje më konkrete në lidhje me problemin. Jo të gjithë do ta kenë të lehtë t'u përgjigjen pyetjeve për punën e fëmijëve. P.sh., nëse të rinjtë do të intervistojnë drejtorin apo përgjegjës të një dyqani që shet prodhime, të cilat janë bërë me punën e fëmijëve, para se të përgjigjet, atij vetë do t'i duhet të mësojë rreth problemit të prodhimit të këtyre artikujve.

Intervista

Më pas ju duhet të kaloni në përgatitjen e një liste me pyetje. Risillni në mendje dhe konsultohuni me dokumentacionin që keni përgatitur në lidhje me realizimin e sondazhit. Për të përgatitur listën e pyetjeve, mund të përdoren të njëjtat parime. Në intervista të kësaj natyre, pyetjet nuk duhet të ndalen në detaje të imta. Dikush duhet



të mbajë shënim përgjigjet, madje ato edhe mund të regjistrohen, pasi njerëzit që do të intervistohen, janë të zënë dhe nuk kanë kohë për të humbur.

Në rast se do të bëni më shumë se një intervistë, ndaheni grupin në nëngrupe të vogla, ku secili prej tyre duhet të merret me listën e pyetjeve për intervistën që do të zhvillojë. Të rinjtë duhet të vendosin edhe si do t'i bëjnë pyetjet, nëse do të bëjë pyetje secili anëtarë i grupit, nëse njëri do të bëjë pyetjet dhe të tjerët do të marrin në shënim përgjigjen, nëse intervista do të regjistrohet apo do të filmohet, nëse është caktuar kush do të merret me këtë gjë, ku do të zhvillohet intervista, në mjedisin ku zhvillohet projekti, në zyrën e personit që do të intervistohet apo në një vend tjetër etj. Pas intervistës mendohet nëse do të parashikohet shtrimi i një koktej apo pirja e një kafeje. Kjo do të ishte një shenjë mirënjohjeje për personin që do të intervistoni.

Të gjitha këto veprimtari përgatitore duhet të diskutohen dhe të vendosen për t'u realizuar nga i gjithë grupi. Nëse përgatitjet për intervistën janë bërë ashtu siç duhet, të intervistuarit kur janë politikanë, biznesmenë apo përfaqësues të sindikatave që i njohin mirë këto situata, do ta kuptojnë menjëherë. Ata do të krijojnë një mendim pozitiv për punën e grupit. Qëllimi i projektit është të krijojë lidhje dhe marrëdhënie të qëndrueshme me komunitetin. Ndoshta grupi do të ketë nevojë të takohet me këta persona në një fazë tjetër të projektit, prandaj duhet të lërë një përshtypje të mirë.

Ftojini grupin të mendojë rreth përgjigjeve që mund të japë i intervistuari për pyetje të caktuar dhe përgatisni pyetje të tjera për t'u thelluar në përgjigje. Gjithashtu, anëtarët e grupit duhet të ushtrohen për mënyrën si do ta zhvillojnë intervistën. Anëtarë të tjerë të grupit do të luajnë rolin e publikut dhe do t'i japin këshilla intervistuesit. Me radhë do të luajnë herë rolin e të intervistuarit, herë rolin e intervistuesit për t'u familjarizuar me procesin..

Nëse keni mundësi, filmojini këto prova për t'i diskutuar më pas më të gjithë grupin. Nëse nuk ka mundësi filmimi, zhvilloni lojën me role, në mënyrë që të gjithë të marrin pjesë dhe të japin këshillat e mundshme në lidhje me zhvillimin e intervistës.

Kur gjithçka të jetë bërë gati për intervistën, edukatori duhet të jetë i pranishëm që të informojë të intervistuarin rreth projektit dhe veprimtarive që janë zhvilluar. Është mirë që ta lini grupin të flasë për projektin. Ky ushtrim ka vlera të mëdha për të përsosur aftësitë shoqërore dhe komunikues të të rinjve. Gjatë intervistës qëndroni pranë të rinjve t'i ndihmoni nëse ajo ngec apo nëse të rinjtë nervozohen. Nëse jeni me fat, i intervistuari do të kuptojë vështirësitë e të rinjve, duke i ndihmuar të mbushin mangësitë që mund të krijohen, si dhe do të nxisë grupin.

Në përfundim të intervistës, pasi të keni pirë diçka dhe të keni shkëmbyer biseda tashmë më të qeta, duhet edhe një herë të falenderoni të intervistuarin. Nëse intervista do të zhvillohet në zyrën apo në shtëpinë e të intervistuarit, detyrën e mikpritjes duhet ta bëjë ky i fundit. Në të tilla raste, gjithmonë duhet ta shoqëroni grupin e të rinjve.



Vazhdimi

Diskutimi pas intervistës bëhet në sesionin e fundit të modulit. Gjithësesi, është e rëndësishme të fusni në mendjen e grupit që intervistat shërbejnë për të forcuar marrëdhëniet me komunitetin, prandaj duhet të vlerësohen shumë personat që pranojnë të intervistohen. Sigurohuni që të gjitha nëngrupet, të cilat kanë realizuar intervista, pas disa ditësh t'u shkruajnë dhe t'u dërgojnë të intervistuarve një letër falenderimi.

Ç'duhet bërë dhe ç'duhet mënjanuar

- Sigurohuni që të gjithë të marrin pjesë në sesionet e këtij moduli. Të marrësh pjesë në përgatitjen dhe realizimin e një sondazhi, nuk është e vështirë. Nëse intervistat zhvillohen nga nëngrupe, është edhe më e thjeshtë që të verifikosh që kanë marrë pjesë të gjithë.
- Nëse keni mundësi, përdoreni vidokamerën dhe kompjuterin.
- Nuk është e detyrueshme të zhvillohen të gjitha ushtrimet e modulit. Në varësi të kohës, burimeve apo kufizimeve të tjera, mund të realizoni vetëm një prej ushtrimeve. Përzgjidhni atë që është më i përshtatshëm për grupin tuaj.
- Gjithçka bëjeni në një atmosferë humori
- Kontrolloni që sondazhet dhe intervistat të diskutohen në detaje.
- Ftojeni grupin të shpërndajë letra falenderimi për personat që qenë të gatshëm për të marrë pjesë. Nënvizoni fuqinë që ka krijimi i marrëdhënieve të mira me komunitetin.
- Përgjashtoni situatat që mund të vënë në vështirësi të rinjtë, veçanërisht ata që e kanë të vështirë të bëjnë intervista. Në të tilla ushtrime, çdo anëtar i grupit duhet të gjejë veten edhe pse nuk merr pjesë drejtpërdrejt në intervistë. Ju, si edukator, duhet të siguronit që të gjithë të marrin pjesë dhe të ndihmojnë sipas mundësive në realizimin e intervistës.

- Sigurohuni që të gjithë anëtarët e grupit të marrin pjesë në shkrimin e letrës, pasi i ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale, personale dhe komunikuese.
- Përfshijeni elementet e garës në vlerësimin e realizimit të detyrave që u keni caktuar të rinjve.
- Shkurtime të lexoni përmbledhjet e të gjitha letrave që keni shkruar jo vetëm ato që ju mendoni se janë më të mirat. Ajo që ka rëndësi në këtë proces, është mendimi dhe qëndrimi i të gjithëve ndaj problemeve. Ju duhet të jeni të paanshëm dhe të mos jepni gjykime.



Diskutimi përfundimtar

1 orë mësimi


Në përfundim të sondazhi apo të intervistës mbledhni grupin në sallën apo klasën tuaj. Nëse ju ka ndihmuar një person i jashtëm, ftojini të marrë pjesë në këtë sesion. Atje të keni edhe të gjitha materialet e prodhuara: relacionin e sondazhit apo filmimin e intervistës.

Përkrahni të gjithë veprimtarinë e kryer nga grupi që nga përgatitja deri në shkrimin dhe realizimin e intervistës apo të sondazhit. Veçoni momentet që kanë qenë më të pëlqyeshme për grupin, si dhe ato ku kanë ndjerë më shumë vështirësi dhe kanë qenë më pak entuziastë. Jepuni mundësi të shpreheshin lirshëm për të gjitha aspektet. Duke u dhënë mundësi të flasin dhe të shpreheshin lirshëm, ju mundësoni krijimin e lidhjeve të forta dhe të qëndrueshme brenda grupit.

Nëse gjatë provave keni filmuar lojën me role apo dhe intervistën e vertetë, ky është momenti që ta shfaqni, nëse nuk e keni bërë më parë. Flisni dhe komentoni përgjigjet që u janë dhënë pyetjeve. Kërkojuni të rinjve të shprehën nëse janë të befasuar apo jo nga përgjigjet, si mendojnë të punojnë për disa përgjigje që u kanë dhënë, a mendojnë se mund të kenë një mbështetje më të madhe në të ardhmen nga të intervistuarit dhe si. Në këtë moment diskutoni me grupin edhe çështjen e fushatës.

Hidhuni një sy rezultateve dhe relacionit të sondazhit: cilat janë reagimet e grupit, a mund të nxiten të shprehën për rezultatet, të përgjigjen për veprimtaritë shoqëruese, të tregojnë nëse janë të kënaqur me to, a mendojnë të zhvillojnë veprimtari të tjera shoqëruese për sondazhet, ndoshta me mediat etj.

Ky ushtrim duhet të përforcojë aftësitë e të rinjve për të zhvilluar veprimtari kërkimore, për të komunikuar me të tjerët dhe për të analizuar dhe për të paraqitur informacionin e marrë. Gjithashtu, do t'i ndihmojë të rinjtë të kuptojnë sa pak i njohur është problemi i punës së fëmijëve në shoqëri. Kjo mund të bëhet një shtysë e re për të ndërmarrë veprimtari të tjera në mbështetje të fushatës për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Nga ana tjetër, do t'u japë të rinjve një mbështetje të vlefshme për të përballuar modulet e mëpasme.



Vlerësimi dhe vazhdimi

Treguesit për të vlerësuar këtë modul janë të shumta. Ndërmjet tyre mund të nxirrni në pah:

- përgatitjen e pyetësorëve për sondazhin;
- realizimin e sondazhit;
- mbledhjen dhe analizën e pyetësorëve të sondazhit;
- përgatitjen dhe mundësisht botimin e raporteve për sondazhet;
- hartimin e listës me kandidatët e mundshëm për t'u intervistuar dhe qëndrimi i tyre ndaj kësaj ftese;
- realizimin e intervistave dhe zhvillimin e marrëdhënieve të mira me të intervistuarit;
- veprimtari të mëtejshme me të intervistuarit në ndihmë të lehtësimit të procesit të integritimit dhe të ndërgjegjësimit në gjirin e komunitetit.



Pa dyshim që ka dhe tregues të tjerë, por nëse janë realizuar ato të sipërpërmendurat, do të thotë se grupi ka punuar mirë dhe do të bënit mirë që këtë gjë t'ia komunikoni. Ushtrimet e këtij moduli mund të jenë shumë interesante dhe argëtuese për të rinjtë dhe mund të rezultojnë shumë efektive për procesin edukativ. Ky modul mund të ketë një ndikim të ndjeshëm në aftësitë e tyre shoqërore dhe komunikuese, si dhe në procesin e zhvillimit dhe të rritjes së gjithësecilit.

Pasi të keni përfunduar këtë modul, mund të kaloni në realizimin e modulit "Integrimi i komunitetit" apo në modulet e artit, sidomos, të dramatizimit.

Shtesa 1

Teknika e intervistës dhe sondazhit ballë për ballë

Nëse sondazhi mbështetet në intervistën e zhvilluar ballë për ballë, grupi duhet të trajnohet për teknikat e intervistave. Kjo do të jetë e dobishme edhe për ushtrimin tjetër të këtij moduli, që është intervista. Që sondazhi të ketë sukses, duhet që pyetjet të jenë të qarta dhe intervistuesi të krijojë një klimë të përshtatshme për të intervistuarin që të përgjigjet qetë dhe lirshëm.

Është e natyrshme që ushtrimet e trajnimit kushtëzohen edhe nga grupi ku i drejtohet sondazhi: do të zhvillohen në rrugë apo në një vend të caktuar, do t'u bëhen një grupi të caktuar njerzish apo njerëzve të çfarëdo mënyre etj. Kështu, mund të mendohet se a mund të zhvillohen në shkollë dhe anëtarë të grupit do të jenë bashkëmoshatarët, mund të mendohet që të rinjtë e grupit do të jenë në kushte të ndryshme nëse e zhvillojnë intervistën në klasë me shokët e tyre apo në rrugë me njerëz të rastësishëm.

Gjithësesi, parimet që udhëheqin sondazhet, janë të njëjta:

- paraqituni dhe shpjegoni se çfarë përfaqësoni, kërkojini personit nëse është i gatshëm të intervistohet, shpjegojini qartë qëllimin dhe objektivat e sondazhit;
- krijoni një klimë pozitive për të intervistuarin;
- filloni me pyetje të thjeshta;
- të jeni gjithmonë i edukuar
- shikojeni drejt në sy të intervistuarin kur bëni pyetje;
- flisni qartë dhe theksoni thelbin e pyetjes, pyetjet mos i shprehni në mënyrë të ngatërruar;
- mirë është të përdorni një regjistruer për ta marrë në shënim përgjigjet, pasi njerëzit nuk kanë kohë dhe mund të mos kenë durim;
- përmbajuni skenarit që keni përgatitur, mos hiqni apo shtoni pyetje, të cilat nuk i keni menduar më parë, këtë gjë mund ta bëni vetëm në ato raste kur pyetjet janë krejt të papërshtatshme për të intervistuarin;
- pasi të keni bërë pyetjen, jepini kohë të intervistuarit të bëjë pyetje edhe ai, të cilave duhet t'u përgjigjeni me edukatë dhe durim;
- në përfundim të intervistës falenderojeni për kohën që ka shpenzuar me ju, si dhe informoheni se kur dhe ku do të botohen rezultatet e intervistave.

Shtesa 2

Rregullat kryesore për të shkruar një letër

Një parlamentar anglez ka thënë: “Unë përfaqësoj në parlament afërsisht 40 000 zgjedhës. 39 000 prej tyre nuk i njoh. Nëse 1 ndër 1 000 zgjedhës më shkruan, do të tregoj interes. Nëse më shkruajnë 50, atëherë filloj të merrem me problemin. Nëse më shkruajnë 100 persona për çështje që kanë të bëjnë me rezultatin e zgjedhjeve dhe nëse më shkruajnë edhe njerëz të tjerë, atëherë mendoj se kam të bëj me ato lloj gjërash që provokojnë revolucionin”.

Kjo është shumë e vërtetë dhe bëhet edhe më shumë e tillë për njerëz që nuk mendojnë se kanë të bëjnë me publikun, si: biznesmenët, drejtuesit dhe blerësit e supermarketeve, përfaqësues të ministrive, të bashkive, si dhe persona të tjerë me pozicione të caktuara. Pra, shfytëzoheni këtë situatë dhe shkruani.

Si rregull i përgjithshëm, letrat duhet të jenë të shkurtëra, të sakta dhe miqësore. Në letër kërkoni një përgjigje duke evidentuar personin dhe adresën kujt duhet t’i përgjigjen. Gjatë shkrimit të letrës mbani parasysh:

- Letrën dërgoheni në vendin e punës dhe jo në adresën e shtëpisë;
- Nëse mundeni, drejtohuni personave që u shkruani me emër, mjaftojnë vetëm pak telefonata për të marrë këtë informacion;
- Mund të përdorni disa metoda, si: p.sh., mund të dërgoni një kartolinë me ngjyra ose një kartolinë të nënshkruar nga 200 veta;
- Nëse merrni një përgjigje për letrën që keni shkruar, shkruani një letër falenderimi.

Në shtesën 3 ju jepen disa shembuj letrash. Letra është diçka personale, fryt i atij që e shkruan. Meqë ne nuk duam të ndikojmë në krijmtarinë dhe fantazinë e të rinjve në vende të ndryshme të botës që zhvillojnë këto module, ju ftojmë të jini shumë të kujdesshëm në përdorimin e modeleve të letrave që po ju paraqesim. Mos i kopjoni dhe t'i shpërndani tek personat që ju keni caktuar për sondazhin apo intervistën. Është mirë t'i përdorni si mjete që do të nxisin diskutimin në grup për formën dhe përmbajtjen që duhet të ketë letra juaj.

Kur ju duhet të shkruani letrën së bashku me grupin, kujtoni që ajo duhet të jetë sa më e thjeshtë dhe e qartë që të jetë e mundshme. Në përgjithësi, një letër e tillë nuk duhet të jetë më shumë se një faqe. Nëse zgjat më shumë se një faqe, bëni të pamundurën që ta mbyllni në mesin e faqes së dytë. Letrat e gjata kanë shumë pak gjasa të lexohen. Në shoqërinë e sotme, koha është shumë e vlefshme. Bëni kujdes që letra të jetë tërheqëse që në rreshtat e parë. Kështu, lexuesi ta lexojë deri në fund.

Shtesa 3

Modele letre

Letër që i dërgohet një organizate për t'i mbështetur

Me këtë letër kërkojmë ndihmën dhe mbështetjen tuaj për një problem që mendojmë se na intereson të gjithëve. Jemi _____(klasa, grupi apo adresa e grupit) dhe po zhvillojmë një projekt, i cili ka si qëllim të ndërgjegjësojë të rinjtë në lidhje me punën e fëmijëve, një problem tepër shqetësues. Projekti ynë bëhet në kuadër të fushtës botërore për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve. Me të dhënat që kemi vjelë, kemi mësuar se sot në botë ka 245 milionë fëmijë nën moshë 18 vjeç që punojnë.

Në realizimin e objektivit tonë për të siguruar mbështetjen dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë, do të ishim të kënaqur dhe të vlerësuar nëse sigurojmë mbështetjen dhe ndihmesën tuaj. E dimë se _____ (emri i organizatës që i drejtoheni) është e përfshirë në trajtimin e problemeve shoqërore, siç është puna e fëmijëve.

Një ndër objektivat tanë është të bëjmë publik këtë problem dhe pikërisht për këtë kërkojmë mbështetjen tuaj. Jemi të mendimit se me ndihmën tuaj mediat, qeveria dhe komuniteti do të dëgjojnë më me vëmendje atë që kemi për të thënë, do të fillojnë të mbajnë qëndrim për punën e fëmijëve dhe për atë që duhet të bëjnë diçka për t'i dhënë fund këtij tmerrri për fëmijët. Nëse të gjithë punojmë së bashku, ndoshta mund t'i ndryshojmë gjërat.

Projekti ynë do të përpiqet të shpërndajë këtë mesazh duke përdorur artin viziv, dramatizimin dhe mjetet e komunikimit masiv. Aktualisht po vëmë në skenë një pjesë për punën e fëmijëve, që e kemi bërë vetë. Shfaqja jonë do të jepet _____ (data dhe vendi ku do të shfaqet). Do të ishim shumë të kënaqur t'ju kishim të pranishëm. Dëshira jonë është ta bëjmë botën një vend më të mirë, më të ndritur dhe më të sigurtë për të gjithë, veçanërisht për fëmijët që janë objekt i shfrytëzimit. E dimë që ndani me ne shpresat dhe endrrat tona. Do të jetë me të vërtetë e dobishme nëse pranoni të mbështetni publikisht projektin tonë.

Ju lutemi të na përgjigjeni sa më parë të jetë e mundshme se koha nuk pret për miliona fëmijë që punojnë në botë.

Letër që i dërgohet një ndërmarrjeje për sponsorizimi

Shënim. Në këtë shembull ndërmarrja është furnizuese e artikujve të kancelarisë

I nderuar z. _____,

Me këtë letër kërkojmë mbështetjen tuaj për një problem që mendojmë se na intereson të gjithëve, pa përjashtim. Jemi _____ (klasa, grupi apo adresa e grupit) dhe po zhvillojmë një projekt që të ndërgjegjësojë të rinjtë në lidhje me punën e fëmijëve, që bëhet në kuadër të fushtës botërore për mënjanimin e plotë saj. Me tmerr kemi mësuar se sot në botë ka 245 milionë fëmijë nën moshën 18 vjeç që punojnë.

Në realizimin e objektivit tonë për të siguruar mbështetjen dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë, do të ishim të kënaqur dhe të vlerësuar nëse sigurojmë edhe mbështetjen e ndihmesën tuaj. Një ndër objektivat tanë të shumtë është të sigurojmë lidhjen dhe solidaritetin e një _____ (emri i shkollës) të _____ (emri i vendit) për t'u dhënë ndihmën tonë të rinjve që janë më me pak fat se ne, veçanërisht për një vend ku ende ekziston puna e fëmijëve. Dëshirojmë që ky problem të bëhet i ditur për të gjithë që ne do të bëjmë ç'është e mundshme për t'i ndihmuar.

Shpresojmë që të sigurojmë edhe ndihmën e komuniteteve të ndryshme të vendit tonë. Nëse të gjithë punojmë së bashku, ndoshta mund të ndryshojmë diçka. Gjatë zhvillimit të projektit kemi arritur të mbledhim _____ (shifrën e shumës së mbledhur) që dëshirojmë ta shpenzojmë për të blerë artikuj shkollorë për një shkollë që ne e sponsorizojmë, _____ (emrin e shkollës). Ne do të lidhemi me nxënësit e kësaj shkolle për të njohur më mirë nevojat e tyre. Për këtë ju drejtohem juve, pasi dëshirojmë të blejmë tek ju artikujt për të cilat ata kanë nevojë. Çmimet tuaja janë të favorshme dhe me siguri do të kemi mundësi të blejmë shumë gjëra.

Shpresojmë në ndihmën tuaj për t'ju blerë këtyre nxënësve sa më shumë artikuj të jetë e mundshme. Nëse do të vendosim që të gjithë fondin që kemi në dispozicion, ta shpenzojmë tek ju, a do të na dyfishonit sasinë e materialeve që do të blejmë? Nëse kërkojmë shumë, ju lutem na bëni ofertën tuaj. Bëhet fjalë për një çështje të drejtë. Këta fëmijë nuk kanë as mjetet më të domosdoshme për t'u shkolluar.

Dëshirojmë t'ju themi diçka më shumë për projektin tonë.

Qëllimi ynë është që duke përdorur artin viziv, artin e të shkruarit, dramatizimin dhe mjetet e komunikimit, të bëjmë publik sa më shumë të jetë e mundshme problemin e punës së fëmijëve (shembulli). Një ndër arritjet e punës sonë është krijimi dhe vënia në skenë e një pjese për punën e fëmijëve.

Për ta bërë botën një vend më të mirë, më të sigurtë dhe më të ndritur për të gjithë, veçanërisht për fëmijët që shfrytëzohen, po japim edhe ne ndihmesën tonë. E dimë që bashkoheni me dëshirat dhe ëndrrat tona. Për këtë do të ishte me të vërtetë e dobishme nëse pranoni ftesën tonë dhe publikisht na mbështesni duke siguruar materialet për shkollim për fëmijët e_____ (vendit). Falë shkollimit, këta fëmijë mund të kenë një të ardhme më të mirë dhe nuk do t'u duhet të punojnë qysh ne moshë të njomë.

Ju lutemi të na përgjigjeni sa më parë të jetë e mundshme se koha nuk pret për miliona fëmijë që punojnë në botë.

Model letre që i dërgohet një ndërmarrjeje për një intervistë

I nderuar z. _____,

Me këtë letër kërkojmë mbështetjen tuaj për një problem që mendojmë se na intereson të gjithëve, pa përjashtim. Jemi _____ (klasa, grupi apo adresa e grupit) dhe po zhvillojmë një projekt që të ndërgjegjësojë të rinjtë në lidhje me punën e fëmijëve, që bëhet në kuadër të fushtës botërore për mënjanimin e plotë të saj. Me tmerr kemi mësuar se sot në botë ka 245 milionë fëmijë, nën moshën 18 vjeç, që punojnë.

Puna që po bëjmë, do të na ndihmojë të shtrijmë përpjekjet tona për të edukuar komunitete dhe njerëz të tjerë. Një ndër komunitetet që interesohet për punën e fëmijëve, është komuniteti i ndërmarrjeve____. Ne jemi të interesuar të kuptojmë më mirë se në ç'mënyrë këto ndërmarrje kontrollojnë politikën dhe strategjitë e blerejve të prodhimeve, duke garantuar që puna për prodhimin e tyre nuk respekton ligjet ndërkombëtare. Si një ndër përfaqësuesit e njërës ndër ndërmarrjet më në zë të komunitetit tonë, do të ishim shumë të interesuar nëse do të pranoni ftesën tonë për t'ju intervistuar në lidhje me këtë problem për të na ndihmuar në përpjekjet tona.

Dëshirojmë që ta bëjmë sa më parë që të jetë e mundshme intervistën me ju. Paraprakisht po ju paraqesim pyetjet për t'ju mundësuar të përgatiteni rreth tyre:

- A ka ____ (emri i ndërmarrjes) një kod sjelleje për politikën e blerjes dhe në rast se po, a mund të na jepni një kopje?
- Në ç'mënyrë ____ (emri i ndërmarrjes) kontrollon zbatimin e këtij kodi?
- A është ____ (emri i ndërmarrjes) pjesë e një nisme për tregtinë e barabartë?
- A përdor ____ (emri i ndërmarrjes) një pjesë të të ardhurave në ndihmë të nismave për botën e tretë, a i mbështet publikisht këto nisma?
- Cili është mendimi i ____ (emri i ndërmarrjes) për punën e fëmijëve? Si e shikon rolin që duhet të luajë dhe ç'përgjegjësi shoqërore ka në fushatën ndërkombëtare për mënjanimin e plotë të punës së fëmijëve?

Ju lutemi na njoftoni sa më parë ditën kur mund ta zhvillojmë intervistën. Mund të na shkruani në adresën ____ (jepni adresën dhe numrin e telefonit të grupit) për të caktuar orën dhe vendin më të përshtatshëm për ju.

Ju lutemi të na përgjigjeni sa më parë të jetë e mundshme se koha nuk pret për miliona fëmijë që punojnë në botë.